

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti për krime të rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Mejreme Memaj, kryetare, Dr.sc.Driton Muharremi, Afrim Shala, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Leonita Lajçi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve F.D. nga Tirana R. e Shqipërisë, E.S. nga Kukëshi R. e Shqipërisë, D.Th. nga Prishtina për shkak të veprës penale në bashkëkryerje kontrabandimi me migrant në tentativë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK dhe P.A. nga Prishtina për shkak të veprës penale në vazhdim kontrabandimi me migrant në tentativë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK, duke vendosur përkitazi me ankesën e mbrojtësve të akuzuarve E.S. dhe P.A., të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.184/2017 datë 22.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.06.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të akuzuarve E.S. dhe P.A., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Ferizaj, PKR.nr.184/2017 datë 22.12.2017, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj-departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.184/2017 datë 22.12.2017, të akuzuarit **F.D.**, **E.S.** dhe **D.Th.** i ka shpallur fajtorë për shkak të veprës penale në bashkëkryerje kontrabandimi me migrant në tentativë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK, ndërsa të akuzuarin **P.A.** veprës penale në vazhdim kontrabandimi me migrant në tentativë nga neni 170 par.1 lidhur me nenin 28 të KPRK, ashtu që të njëjtit për këto vepra penale i gjykon dhe atë: **F.D.** me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 euro, dënimi me burg do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, në dënim me burg do ti llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim nga data e arrestimit 09.02.2017 deri me dt. 22.12.2017, ndërsa dënimi me gjobë nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një)

viti pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale. Të akuzuarin **E.S.** me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 euro, dënimi me burg do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, në dënimin me burg do ti llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim nga data e arrestimit 10.09.2017 deri me dt. 22.12.2017 ndërsa dënimi me gjobë nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 viti pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale. Të akuzuarin **D.Th.** me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 euro, dënimi me burg do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, në dënim me burg do ti llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim nga data e arrestimit 25.09.2017 deri me dt. 22.12.2017 ndërsa dënimi me gjobë nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 (një) viti pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale. Të akuzuarin **P.A.** me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe dënim me gjobë në shumë prej 300 euro, dënimi me burg do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, në dënim me burg do ti llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim nga data e arrestimit 25.09.2017 deri me dt. 22.12.2017 ndërsa dënimi me gjobë nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afatin prej 1 viti pasi aktgjykimi të merr formën e prerë nuk kryen vepër tjetër penale. Konform nenit 116 par.1 të KPPRK-së i kthehet pronarit Rent a Car “SHPK” Genti në Prishtinë vetura e markës Opel Zafira me targa 01-638-IM e sekuestruar përkohësisht me qe nuk ka bazë për konfiskimin e sajë. Konform nenit 69 të KPPK konfiskohet dobia pasurore nga i akuzuari **F.D.** dhe atë 300 euro, sepse janë fituar me vepër penale. Konform nenit 284 par.6 të KPPK me parat e konfiskuara në shumën prej 500 euro do të menaxhoj Agjensioni për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar, kurse pasi aktgjykimi të merr formën e prerë do ti shfrytëzoj në dobi të buxhetit të Kosovës. Janë obliguar të akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj secili veç e veç shumën prej 50 euro në afat prej 15 ditëve nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm kurse shpenzimet tjera procedurale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ankesë kanë paraqitur:

- Mbrojtësi i të akuzuarit E.S. av. A.I., për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën, aktgjykimi kundërshtuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënim ashtu që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i butë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit P.A., av. F.K., për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën, aktgjykimin e kundërshtuar ta ndryshoj dhe të i shqiptoj dënim më të butë.

- Prokurori i Apelit me parashtresën me shkrim PPA/I.nr.203/2018 të dt. 10.05.2018 ka propozuar që ankesat e mbrojtësve të akuzuarve E.S. dhe P.A. të refuzohen si të pa bazuara.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në të cilën nuk mori pjesë Prokurori i Apelit dhe të akuzuarit ndërsa prezent ishin mbrojtësit F.K. dhe me autorizim zëvendësues për av. A.I.n, av. N.I. dhe av. A.M.. Mbrojtësit av. N.I. dhe av. F.K., mbetën pranë ankesave të bëra me shkrim.

Gjykata e Apelit e Kosovës pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështjeje juridiko-penale studio aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-ankesat janë të pa bazuara.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoi edhe në këtë aspekt, konstatoi se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. As gjendja faktike nuk qe objekt vlerësimi i kësaj Gjykate, ngase nuk është kontestuar me ankesë, prandaj aktgjykimin e ankimuar e vlerësoi vetëm në frymë të pretendimeve ankimore.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të mbrojtësve të akuzuarve lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesat janë të pa bazuara. Në ankesën e mbrojtësve të akuzuarve nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Mbrojtësi i të akuzuarit E.S. thekson se i mbrojturi i tij është i pa gjykuar më parë, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, qëndrimi i tij gjatë procedurës ishte i sinqertë dhe korrekt duke shprehë keqardhje të plotë dhe të lartë për veprimet e tij, duke shprehur një pendim real dhe të plotë dhe zotimin se do të përmbahet në të ardhmen nga veprimet e ndaluara me ligj si dhe pranimi i fajësisë në shqyrtimin fillestar. Ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit P.A. av. F.K., thekson se duke pas parasysh pranimin e fajësisë, pendimin dhe premtimin e të akuzuarit se në të ardhmen nuk do të vjen në konflikt me ligjin, më parë i pa dënuar, mosha relativisht e re, gjendja e rëndë ekonomike, se është mbajtës i familjes janë rrethana të cilat japin mundësinë që të shqiptohet një dënim më i butë. Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe atë për të akuzuarin E.S. rrethana veçanërisht lehtësuese mosha e tij e re, pranimi i fajësisë, pendimi për veprën e kryer ndërsa si rrethanë rënduese shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale, si dhe për të akuzuarin P.A. po ashtu moshën e tij të re, pendimin dhe pranimin e fajësisë e po

ashtu edhe për të njëjtin rrethanat rënduese si shkalla e përgjegjesisë penale dhe rrezikshmëria e veprës penale vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjesisë penale të akuzuarve si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimet nën minimumin e paraparë ligjor dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 41 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.214/18, më 18.06.2018

Procesmbajtës,
Leonita Lajçi

Kryetare e kolegjit- gjyqtarja
1. Mejreme Memaj_____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi_____

3. Afrim Shala _____